



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228838

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505757

C.nr.298/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekalii, me bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses B., të cilën e përfaqëson F.L., kundër të paditurit B.M nga fshati Vilanc, komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. N.B. me seli të zyrës në Vushtrri, me objekt kontesti rimbursimin e dëmit, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 1,095.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më datë 25.03.2024, në seancë publike, në prezencën e të autorizuarit të paditëses Fadil Limani, të paditurit B.M.dhe të atuarizuarit të tij Av. N.B., me datë 26.03.2024 nxjerri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B., me seli në Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri B.M.nga fshati Vilanc, komuna e Vushtrrisë që paditëses t’ia paguaj shumën prej 757.50 € (shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë Euro e pesëdhjetë cent), në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.01.2015, në ora 15:43 minuta, në Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 03.07.2018, dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit në shumë prej 547.50 Euro si e PABAZUAR

II. DETYROHET i padituri B.M., që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore për padi, shumën prej 30.00 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim

A r s y e t i m

Paditësja B., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.N., me datë 02.07.2018, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit B.M. nga fshati Vilanc, komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. N.B. me seli të zyrës në Vushtrri, për shkak të rimbursimit të dëmit, me vlerë të kontestit prej 1,095.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 12.01.2015, në ora 15:43, në Prishtinë.

Gjykata, me datën 07.03.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore ku palët kanë mbetur pran kërkesave respektivisht kundërshtimeve të tyre, ndërsa i autorizuari i të paditurit i ka propozuar gjykatës që të caktoj nxjerrjen e provës me ekspertizë përmesë ekspertizës së komunikacionit. Gjykata po të njëjtën ditë, me aktvendim ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të të paditurit, ashtu që ka caktuar nxjerren e provës me ekspertizë, dhe ka caktuar ekspertin e komunikacionit dhe makinerisë S.B. me detyrën që i njëjti të përcaktoj se me përgjegjësinë e kujt ka ardhur deri të aksidenti i datës 12.01.2015. Eksperti i caktuar nga gjykata, me datën 13.03.2024, gjykatës, i'a ka dorëzuar ekspertizën me shkrim.

I autorizuari i paditëses, në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën t'a aprovoj si të bazuar, dhe të detyrohet i padituri që paditëses B., t'ia rimbursoj shumën prej 1,095.00 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.01.2015, dhe atë duke llogaritur edhe kumatën ligjore nga data e ndritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, dhe atë taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30.00 Euro nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I autorizuari i të paditurit në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, me administrimin e provave, u vërtetua se baza e përgjegjësisë në shkaktimin e këtij aksidenti të komunikacionit, bie edhe te pala tjetër, me kontribut prej 50% me 50%, ashtu që gjykatës i ka

propozuar që padinë dhe kërkespadinë t'a refuzoj si të pabazuar pasi që nuk është bërë precizimi i sakt, duke kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së, ka administruar provat si, Dosja e dëmit me numër 140/2015; Urdhërtransferi për të dëmtuarit L.B. dhe F.B., i datës 16.03.2015; Ujdia jashtgjyqësore e datës 03.03.2015, për të dëmtuarin L.B.; Ujdia jashtgjyqësore e datës 03.03.2015 për të dëmtuarën F.B. Raporti i aksidentit 2015AR-0079, i datës 12.01.2015, së bashku me skicën e aksidentit; Konfirmimi i sigurimit i datës 02.02.2015; Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit S.B., e datës 13.03.2024.

Nga ujdia jashtgjyqësore, e datës 03.03.2015, për të dëmtuarin L.B. dhe ujdia jashtgjyqësore e datës 03.03.2015 për të dëmtuarën F.B., vërtetohet se paditësja ka lidhur marrëveshje jashtgjyqësore me të dëmtuarit për kompensim në vlerën e kërkesëpadisë, pra shumën prej 1,095.00 Euro.

Nga urdhërtransferi i datës 16.03.2015 për të dëmtuarin L.B. dhe urdhërtransferi i datës 16.03.2015 për të dëmtuarën F.B., vërtetohet se paditësja, të njëjtëve u'a ka kompensuar shumën në vlerën e kërkesëpadisë, pra shumën prej 1,095.00 Euro.

Nga raporti i aksidentit me numër 2015AR-0079, të datës 12.01.2015 dhe skica e aksidentit, konstatohet rrjedha e shkaktimit të aksidentit me datën 12.01.2015, ora 15:43 në Prishtinë.

Nga konfirmimi i sigurimit i datës 02.02.2015, vërtetohet se i padituri ka drejtuar mjetin pa mbulesë siguroese, gjegjësit mbulesa siguroese i ka skaduar me datën 17.12.2014.

Nga ekspertiza e komunikacionit e datës 13.03.2024 e ekspertit S.B, vërtetohet se Ekspertiza e komunikacionit e datës 13.03.2024 ka nxjerr konstatimin se në këtë rast kanë ndodhur dy aksidente brenda një intervali të shkurtër kohor dhe atë:

Aksidenti i parë ndërmjet automjeteve "A" (Alfa Romeo) dhe "B" (N.N.) – ka ardhur nga lëshimet e ngasësit të automjetit "A", pra ngasësi "A" (L.B.) është shkaktar i aksidentit –I-, ndërsa ngasësi "B" (N.N.) nuk i ka dhënë kontribut aksidentit, dhe

Aksidenti i dytë ndërmjet automjeteve "C" (VË) dhe "A" (Alfa Romeo) – ka ardhur nga lëshimet e ngasësit të automjetit "C", pra ngasësi "C" (Besim Maksuti) është shkaktar i aksidentit –II- ndërsa ngasësi "A" dhe ngasësi "B" nuk i kanë dhënë kontribut aksidentit –II-.

Për lëndimet e pasagjerit në automjetin “A” – janë shkaktar dy ngasësist e automjeteve “A” dhe “C” pra “A” – Lumni Berisha dhe “C” – B.M.= kontributi i dy ngasësve është solidar (i barabart)

Pra shkaktar i vetëm i aksidentit –II- është i padituri B.M. i cili nuk ka mbajtur distancën e duhur të sigurisë ndërmjet automjetit para tij, si pasoj e kësaj është shkaktuar aksidenti –II-, ndërsa i padituri, në lëndimet e të dëmtuarës F.B. është përgjegjës vetëm në shkallë prej 50% pasi që edhe ngasësi tjetër i automjetit ‘A’ mban 50% të përgjegjësisë për shkak të mos mbajtjes së distancës së duhur të sigurisë ndërmjet automjetit para tij.

Pas administrimit dhe analizimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 të LPK-së, gjykata vlerësoi se nuk janë kontestuese këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë pjesëmarrës dhe shkaktar i vetëm i aksidentit – II- me datën 12.01.2015, rreth orës 15:43, në Prishtinë, me automjetin VË Passat -2 , në të cilin aksident i padituri si drejtues i automjetit “C” nuk ka mbajtur distancën e duhur të sigurisë me mjetin përpara tij, dhe si pasoj e kësaj ka ardhur deri te aksidenti –II-.

Nuk është kontestues fakti, se të dëmtuarit L.B.dhe F.B. janë kompensuar për aksidentin e ndodhur në shumë prej 1,095.00 Euro, dhe atë i dëmtuari L.B.në emër të dëmit material është kompensuar në shumë prej 420.00 euro dhe Fatmire Berisha në emër të zhdëmtimit është kompensuar me shumën prej 675.00 euro, pasi që të njëjtit e kanë fituar të drejtën e kërkesës ndaj paditësit si pasoj se automjeti “C” ka qenë pa mbulesë sigurore.

Nuk është kontestuese se automjeti “C”, pra VË Passat -2, i drejtuar nga i padituri B.M.në kohën e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë sigurore, gjegjësit me mbulesë sigurore të skaduar.

Baza ligjore e kërkesëpadisë së paditëses rrjedhë nga neni 18 paragrafi 1 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku parashihet se *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Po ashtu, gjykata vlerëson se e drejta për regres paditëses, i takon edhe në bazë të paragrafit 3 të të njëjtit nen *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3.*

i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”, ku në këtë procedurë kontestimore, u vërtetua fakti se paditësja e kishte përmbushur detyrimin ndaj palëve të treta, të cilës i padituri iu kishte shkaktuar dëm material dhe jomaterial.

Gjykata, gjeti se padia e paditëses duhet të aprovohet pjesërisht, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se i padituri ka qenë shkaktar i vetëm i aksidentit –II- por në të njëjtën kohë dhe për dëmtimet materiale të shkaktuar në automjetin e të dëmtuarit L.B., është shkaktar i vetëm i atij dëmi, ndërsa sipas ekspertizës ka vetëm 50% të përgjegjësisë në lëndimet që ka pësuar në këtë aksident e dëmtuara F.B., ashtu që gjykata, duke qenë se i padituri është përgjegjës i vetëm në shkaktimin e aksidentit –II- por mban vetëm 50% të përgjegjësisë në lëndimet e marra në këtë aksident nga e dëmtuara F.B., aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe atë vetëm shumën prej 757.50 Euro, e cila shumë përbehet për rimbursimin e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit L.B. në lartësi prej 420.00 euro, dhe 50% e shumës prej 675.00 euro, përkatësisht shumën prej 337.50 euro, si shumë e cila i përgjigjet përgjegjësisë së tij në shkaktimin e aksidentit.

Lidhur me pjesën refuzuese, dhe atë pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vlerësoi, se meqenëse i padituri është vetëm 50% përgjegjës në lëndimet e pësuar nga e dëmtuara F.B., e cila nga paditësja është kompensuar në shumë prej 675.00 Euro, gjykata për këtë, refuzoi si të pabazuar shumën prej 337.50 Euro.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën ligjore, gjykata vendosi konform nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së duke filluar nga data 03.07.2018, dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive të detyrimit.

Gjykata, për shpenzimet e procedurës, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenin 452 par. 1 të LPK-së, ashtu që obligoj të paditurit si palë e cila e ka humbur kontestit, që t’ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurës, dhe atë për taksën gjyqësore për padi, shumën prej 30.00 euro.

Andaj, bazuar në të lartcekurat e në pajtim me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI,

Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile

C.nr.298/18, datë, 26.03.2024

Gj y q t a r i,
Naim Rekaliu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.